

U D H Ë Z I M
Nr. 7, datë 18.6.2002

**PËR VENDOSJEN E KOPJEVE ORIGJINALE TË TABELAVE, PROCESVERBALEVE
DHE VULËS SË KQV-SË NË KUTINË E VOTIMIT QË PËRMBAN FLETËVOTIMET PËR
DEPUTET NË ZONËN NJËEMËRORE**

Në bazë të nenit 106 pika 6 e ligjit 8609, datë 8.5.2002 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

U D H Ë Z O N:

1. KQV-ja pas numërimit të fletëvotimeve për deputetë të drejtpërdrejtë në zonën njëemërore, zarfet me fletëvotimet e përdorura dhe të papërdorura i fut në kutinë e votimit. Mbi bazën e fletëvotimeve të përdorura plotësohet “Tabela e rezultateve të qendrës së votimit nr._____, për deputet të drejtpërdrejtë në zonën zgjedhore nr.19” (modeli 54).

2. Pas plotësimit të tabelës model 54, kryetari i KQV-së plotëson “Tabelën e përgjithshme të rezultateve të qendrës së votimit Nr._____, të zonës zgjedhore nr.19”, modeli 56, e cila përmbledh të dhënat e tabelës së mësipërme, model 54.

3. Kopjet origjinale të dy tabelave (modelet 54 dhe 56), si dhe procesverbalet dhe vula e KQV-së vendosen në kutinë e votimit. Një kopje tjetër origjinale e tabelave model 54 dhe 56 e plotësuar, vendosen në një zarf të veçantë.

4. Kutia e votimit vulolet me vulat jeshile dhe numrat identifikues të vulave regjistrohen në fletoren e procesverbalit të KQV-së.

5. Kryetari, Zëvendëskryetari dhe Sekretari i KQV-ve të zonës zgjedhore nr.19 i dorëzojnë KZZ-së nr.19, brenda 24 orëve nga mbyllja e votimit, kutinë e votimit dhe zarfin me tabelat e rezultateve të votimit.

KZZ-ja i lëshon kryetarit të KQV-së një procesverbal dorëzimi, sipas modelit të miratuar nga KQZ-ja.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI
Sokol Shazi